



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. _____ Pro

Tiranë, më ____ .02.2023

Lënda: Kërkesë për paraqitjen e një pyetje drejtuar Kryeministrit në Seancën e Përjavshme të Pyetje-Përgjigjeve (Neni 95 i Rregullores së Kuvendit).

Drejtuar: ZNJ. LINDITA NIKOLLA,
KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË.

Zonja Kryetare e Kuvendit,

Kjo kërkesë bazohet në Nenin 95 “**Seanca e përjavshme e pyetje-përgjigjeve**” e Rregullores së Kuvendit. Sipas këtyre dispozitave të rregullores:

- “1. Një herë në javë, të mërkurave, zhvillohet seanca e përjavshme e pyetje- përgjigjeve jo më shumë se 60 minuta.*
- 2. Pyetjet për seancën e përjavshme të pyetje-përgjigjeve paraqiten me shkrim deri ditën e hënë në orën 14:00 në sekretarinë e Kuvendit. **Pyetjet i paraqiten menjëherë Kryeministrit dhe anëtarit të Këshillit të Ministrave, të cilit i janë drejtuar.***
- 3. **Çdo deputet, në seancën e përjavshme të pyetje-përgjigjeve, ka të drejtë të paraqesë një pyetje të vetme, të formuluar qartë dhe në mënyrë të përmbledhur për një çështje urgjente ose me interes të gjerë publik ose politik.***
- 4. Çdo deputet, që ka paraqitur pyetjen për seancën e përjavshme të pyetje-përgjigjeve, mund ta parashtrojë atë për një kohë jo më të gjatë se 2 minuta. Kryeministri ose ministri përgjigjet për pyetjen e bërë jo më shumë se 5 minuta dhe, pas kësaj, pyetësi ka përsëri të drejtën të flasë deri në 3 minuta. Pyetjeve fillimisht u përgjigjet Kryeministri ose Zëvendëskryeministri dhe më pas vijohet me ministrin, të cilit i janë drejtuar numri më i madh i pyetjeve. [...]”.*

Ditët e fundit opinionin publik shqiptar dhe ndërkombëtar është tronditur prej një skandali të përmasave ndërkombëtare që ka përfshirë ish-Drejtorin e FBI Charles McGonigal dhe Kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama.














Ky është një rast i paprecedentë, kur Kryeministri në detyrë i një vendi bëhet objekt dyshimi dhe akuze për kontakte të papërshtatshme me një zyrtar të niveleve më të larta të FBI. Ndaj, duke patur parasysh përmasën e jashtëzakonshme të këtij skandali të paprecedentë, ku Kryeministri shqiptar Edi Rama përfshihet si subjekt hetimi dhe akuzash për përfshirje në korrupsion ndërkombëtar, minimin e besimit të publikut ndaj institucioneve të Shtetit shqiptar dhe

cënimin e marrëdhënieve politike dhe diplomatike ndërshtetërore ndërmjet Shqipërisë dhe SHBA, si dhe bazuar në Nenin 95 të Rregullores së Kuvendit, deputetët e poshtëshënuar, i paraqesin Kryeministrit këto pyetje:

1. Sa herë Kryeministri Edi Rama është takuar me McGonigal, sa prej këtyre takimeve takimeve kanë qenë zyrtare dhe a është ndjekur rruga institucionale zyrtare për vendosjen dhe zhvillimin e secilit prej këtyre takimeve? Nëse jo, përse nuk është ndjekur kjo rrugë? Përse nuk është bërë asnjë njoftim zyrtar për takimet? Cilat kanë qenë temat e bisedimeve? Cilat kanë qenë temat e bisedimeve?
2. A kanë marrë pjesë përfaqësues të ambasadës amerikane në Shqipëri apo përfaqësues të ambasadës shqiptare në ShBA në takime? Cilët përfaqësues të tjerë të shtetit shqiptar kanë marrë pjesë në këto takime?
3. A ka takuar përfaqësues të tjerë të shtetit shqiptar z.McGonigal dhe a i kanë raportuar ata këto takime tek Kryeministri?
4. Me çfarë statusi kanë marrë pjesë në takime personi A) Agron Neza dhe personi B) Dorian Duçka? Cila është natyra e marrëdhënieve të Kryeministrit me personin A, personin B, dhe z.McGonigal? A është diskutuar në këto takime për çështje që përbëjnë ndikim të paligjshëm apo konflikt interesi në favor të personave A dhe B? A është diskutuar për çështje zyrtare të natyrës konfidenciale në këto takime në prani të personave A dhe B?
5. Cili ka qenë motivi i zhvillimit të takimeve kaq të shpeshta që nga shtatori 2017 deri në maj 2018? A ka patur komunikime të tjera përveç takimeve gjatë kësaj periudhe me z.McGonigal, përfshirë telefonata, mesazhe, emaile? Cilat kanë qenë natyra dhe motivi i këtyre komunikimeve? A kanë vepruar në emër të, apo për llogari të Kryeministrit Rama personat A dhe B me z.McGonigal? A ka zhvilluar veprimtari në ShBA, Shqipëri apo vend tjetër, personi A me porosi të, në shërbim të, apo në emër të Kryeministrit shqiptar?
6. A ka zhvilluar veprimtari në ShBA, Shqipëri apo vend tjetër, personi B me porosi të, në shërbim të, apo në emër të Kryeministrit shqiptar? A kanë kryer shkëmbime të natyrës materiale, monetare, pasurore personat A dhe B në emër të, me porosi të Kryeministrit shqiptar ndaj personave të tretë, përfshirë z.McGonigal?
7. Me çfarë statusi i është lidhur adresë zyrtare emaili personit B nga shteti shqiptar? Cili institucion e ka lidhur këtë adresë zyrtare dhe mbi ç'bazë ligjore? Cili institucion ka lëshuar pasaportë zyrtare për personin B dhe mbi cilën bazë ligjore?
8. Sipas, aktakuzës në Uashington DC, personi A ka përcjellë tek z.McGonigal materiale të përgatitura nga zyra e Kryeministrit. Çfarë materialesh janë përcjellë? Kush i ka përgatitur ato? Kush i ka dërguar ato?
9. Po sipas aktakuzës, z.McGonigal i është kërkuar nisja e një hetimi ndaj një lobuesi që punonte për llogari të opozitës shqiptare dhe i janë vënë në dispozicion të dhëna dhe dëshmitarë për këtë? Përse nuk është ndjekur rruga zyrtare për këto pretendime? Cili është burimi i këtyre të dhënave?
10. Me çfarë statusi ligjor marrin personat A dhe B në shkëmbimin e këtyre të dhënave mes dy zyrtarëve të lartë shtetërorë? Me çfarë statusi ligjor shoqërojnë personat A dhe B dëshmitarë për llogari të institucioneve shqiptare? A ka përfshirë Kryeministri, apo person tjetër në emër të tij, ndonjë institucion tjetër zyrtar shqiptar në këto hetime?
11. A ka përfshirë Kryeministri, apo person tjetër në emër dhe në shërbim të tij, zyrtarë të tjerë të huaj në këto hetime?

12. A u është ofruar shërbime dhe/ose përfitime të natyrave të ndryshme z. McGonigal, z. Rossini, z. Neza, z. DUCKA dhe/ose personave të tjerë të lidhur me ta nga qeveria Shqiptare?
13. A ka qene në dijeni Kryeministri për hetimet e zhvilluara nga FBI ndaj z.McGonigal? A ka qenë në dijeni për sigurimin e provave që dëshmojnë komunikimet dhe veprimtarinë e z.McGonigal në marrëdhënie me të dhe zyrtarë të tjerë të qeverisë shqiptare. A i është kërkuar Kryeminsitrit gjatë kësaj kohe të japë dëshmi mbi natyrën, dendësinë dhe përbajtjen e marrëdhënieve/takimeve/kontakteve me z.McGonigal?

DEPUTET

Suli Benica 
 Demian Noka  Petrit Vasilij 
 Triton Shkurr  Monika Kryemadhi 
 Albesa Vokshi 
 Luam Baci 
 Edmond Spaho  Espelie 
 Luciano Bogi 
 Ina Zhupa 
 Isuf Celaj 
 AGRON SHIHAS  Agron Shihash
 Oerol Bylykbashi 